



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 8.07.2019

Dokument parlamentar

Komision përgjegjës)

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCave DHE EKONOMISË, (HUAMARRËSI), FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT (AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT), DHE KFË FRANKFURT AM MAIN (KfW), PËR PROGRAMIN E FURNIZIMIT ME UJË TË ZONAVE RURALE IV”

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 8.07.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, (Huamarrësi), Fondit Shqiptar të Zhvillimit, (Agjencia e zbatimit të projektit), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e furnizimit me ujë të zonave rurale IV”, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Znj. Antoneta Dhima.

Për të paraqitur projektligjin në emër të Qeverisë, ishin present përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

II. Baza ligjore Kushtetuese

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj dhe në përmbushje të nenin 17, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

III. Qëllimi i projektligjit dhe përshkrim i termave të huas.

Qëllimi i projektligjit

Projektligji synon ratifikimin e marrëveshjes së huas, të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e huamarrësit, Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në cilësinë e agjencisë së zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt Am Main, për financimin e programit të furnizimit me ujë të zonave rurale IV.

Kjo marrëveshje huaje ka për qëllim financimin e fazës së katërt të programit të furnizimit me ujë të zonave rurale, nëpërmjet akordimit nga KfW-ja të një huaje në shumën 40 000 000 (dyzet milionë) euro.

Këto fonde huaje do të përdoren ekskluzivisht për rehabilitimin dhe shtrirjen e sistemeve të furnizimit me ujë, kanalizimeve dhe sistemeve të trajtimit të ujërave të ndotura, si dhe për shërbimet e konsulencës në lidhje me zbatimin e projektit në zonën bregdetare të jugut të Shqipërisë dhe do të përfshijë zonat në Bashkinë Himarë, (qyteti i Himarës dhe fshatrat Kuç, Buronjë (afër Kuç), Pilur, Kudhës, Vuno, Jalë, Livadhi, Himara Fshat, Qeparo e Borsh).

Gjithashtu do të mundesohet vënia në punë e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura të Orikumit, instalimi i lidhjeve familjare për ujësjellësin në qytetin e Orikumit, duke qenë se projektet për këto bashki nuk mundën dot të zbatoheshin në kuadër të fazës së tretë të programit, për shkak të fondeve të limituara.

Termat e Huas

Huaja që do të akordohet nga KfW-ja nuk kalon vlerën 40 000 000 (dyzet milionë) eurosh, me termat e mëposhtëm financiarë të dakordësuar në marrëveshje:

- Norma fikse e interesit do të përcaktohet në momentin e bërjes efektive të huas;
- Tarifa e menaxhimit do të jetë në masën 1% të shumës së huas;
- Tarifa e angazhimit do të jetë 0.25% në vit, për shumat e padisbursuara të huas dhe do të jetë e kërkueshme për pagesë çdo vit në bazë gjashtëmujore;

- Maturimi i huas do të jetë për 15 vjet, duke përfshirë periudhën prej 3 vitesh pa pagesë principali.
- Afati i disbursimit të huas është deri në datën 30.3.2024.

IV. Efektet financiare

Projekti është parashikuar në programin buxhetor afatmesëm 2019-2021 të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, më konkretisht në programin “Furnizimi me ujë i zonave rurale IV”.

V. Shqyrtimi i projektligjit në komision.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në komisionin, relatori shpjegoi se, ai vjen në vijim dhe zbatim të marrëveshje bazë, “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2018, për projektin “Programi sektorial i ujërave/furnizimi me ujë i zonave rurale IV”, e cila u miratua në seancën plenare të datës 4 korrik 2019, dhe që i mundësoi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, marrjen nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) të një kredie të butë, në vlerën 40 milionë euro dhe një grant në vlerën 2 milionë euro.

Projektligji është vijim dhe zbatim i kësaj marrëveshje bazë, duke konkretizuar dhe përcaktuar në terma konkret kushtet e kësaj huaje. Ai synon ratifikimin e marrëveshjes së huas, të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e huamarrësit, Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në cilësinë e agjencisë së zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt Am Main, dhe ka për qëllim financimin e fazës së katërt të programit të furnizimit me ujë të zonave rurale, nëpërmjet akordimit nga KfW-ja të një huaje në shumën 40 000 000 (dyzet milionë) euro, e cila do të përdoret për rehabilitimin dhe shtrirjen e sistemeve të furnizimit me ujë, kanalizimeve dhe sistemeve të trajtimit të ujërave të ndotura, si dhe për shërbimet e konsulencës në lidhje me zbatimin e projektit në zonën bregdetare të jugut të Shqipërisë dhe do të përfshijë zonat në Bashkinë Himarë dhe Orikumi.

Ky program mbështetet në Strategjinë Kombëtare për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 dhe vlerësohet se do të ketë impakt pozitiv për popullsinë rezidente dhe turistët e shumtë në këtë zonë, duke e çuar kështu numrin e përfituesve në 80 000, përfshirë turistët.

Pikësynimi i Qeverisë Shqiptare është zhvillimi i koncepteve afatgjata për përmirësimin e furnizimit me ujë dhe të infrastrukturës së kanalizimeve për të gjithë hapësirën e këtyre bashkive dhe për këtë arsye, është kryer edhe një studim fizibiliteti i financuar nga qeveria Gjermane, i cili ka përfunduar në dhjetor 2018, për Bashkinë Himarë dhe një studim fizibiliteti

për njësinë administrative Orikum, i përfunduar në shkurt 2019. Këto studime do të shërbejnë si bazë për investimet e planifikuara për t'u realizuar në këto Bashki.

Termat e Huas

Huaja që do të akordohet nga KfW-ja nuk kalon vlerën 40 000 000 (dyzet milionë) eurosh, me termat e mëposhtëm financiarë të dakordësuar në marrëveshje:

- Norma fikse e interesit do të përcaktohet në momentin e bërjes efektive të huas;

Pra norma e interesit të huas do të përcaktohet nga KfW-ja, pas dy ditëve pune nga marrja e njoftimit se janë përmbushur kushtet e bërjes efektive të marrëveshjes së huas (kusht ky i diktuar nga KfW-ja, për shkak se kredia akoma nuk është efektive dhe nuk konsiderohet kredi e angazhuar për vendin tonë dhe si e tillë nuk ka një bazë ligjore për KfW-në për të përcaktuar normën e interesit).

Sipas marrëveshjes bazë qeveritare të miratuar, jemi në kushtet e një kredie të butë, dhe duke iu referuar historikut të bashkëpunimit me KfW-në, rezulton se kryesisht kreditë e akorduara prej saj, në dhjetë vitet e fundit kanë pasur norma interesi të fiksuara në nivelin prej rreth 1-2%. Kjo mënyrë e përcaktimit të normës së interesit është aplikuar në vijimësi edhe në marrëveshjet e mëparshme. Këto lloj normash, krahasuar me instrumentin më afatgjatë të huas që ka vendi ynë në tregun ndërkombëtar (Eurobondi 2018), janë rreth tre herë më të ulëta, kjo duke marrë parasysh për më tepër që edhe afati i maturimit të huas së KfW-së është më i gjatë sesa afati i Eurobondit.

Edhe për huan që synohet të përfitohet me anë të kësaj marrëveshjeje, parashikohet që norma të jetë poshtë nivelit prej 2%. Konkretisht, në ditën e negociimit të marrëveshjes së huas, norma indikative e interesit ishte 1.1%.

Lidhur me termat e tjerë financiarë të dakordësuar në marrëveshje rezulton se:

Tarifa e menaxhimit do të jetë në masën 1% të shumës së huas; tarifa e angazhimit do të jetë 0.25% në vit, për shumat e padisbursuara të huas dhe do të jetë e kërkueshme për pagesë çdo vit në bazë gjashtëmujore; maturimi i huas do të jetë për 15 vjet, duke përfshirë periudhën prej 3 vitesh pa pagesë principali dhe afati i disbursimit të huas është deri në datën 30.3.2024.

Kostoja totale e projektit

Kostoja totale e projektit "Furnizimi me ujë i zonave rurale IV" vlerësohet të jetë 45.15 milionë euro (pa përfshirë këtu vlerën e TVSH-së apo taksa të tjera që lindin nga projekti që do të mbulohen nga buxheti i FSHZ-së), kosto e cila do të financohet nga:

- huaja në fjalë në vlerën prej 40 milionë euro;

- buxheti i shtetit në vlerën 1.35 milionë euro;
- granti që do të akordohet nga KfW-ja në vlerën 2 milionë euro;
- granti që do të akordohet nga WBIF-ja në vlerën 1.8 milionë euro.

VI. *Përfundime*

Në përfundim, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, duke evidentuar faktin se kjo marrëveshje është në përputhje me Kushtetutën si dhe legjislacionin në fuqi për marrëveshjet ndërkombëtare si dhe duke vlerësuar se marrëveshja do të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe do të promovojë zhvillimin e turizmit në zonën e projektit, me votat pro të të gjithë anëtarëve të pranishëm e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi.

RELATOR

Antoneta DHIMA

KRYETAR

Arben AHMETAJ